



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 1572/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbareme të kreditorit N.T.SH "M..." me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim, Y.B nga Prishtina, kundër debitorit "Radio Televizioni i Kosovës" - RTK me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbareme P.nr.816/21 të datës 31.12.2021 të Përmbaremit Privat Irfan Kërçagu, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 21.11.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit "Radio Televizioni i Kosovës" RTK me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër urdhrit përmbareme P.nr.816/21 të datës 31.12.2021 të Përmbaremit Privat Irfan Kërçagu.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.816/21 i datës 31.12.2021 i lejuar nga Përmbaremi Privat Irfan Kërçagu

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat Irfan Kërçagu, duke vepruar sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit N.T.SH "M...", në bazë të titullit ekzekutiv – Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.76/2020 të datës 09.11.2021 ka nxjerr urdhrin P.nr.816/21 me datën 31.12.2021, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbaremit, ndaj debitorit Radio Televizioni i Kosovës" RTK me seli në Prishtinë, duke e detyruar debitorin që kreditorit t'ia paguaj shumën prej 66,246.67 €, me kamatë që paguajnë bankat komerciale për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë 23.05.2012 e deri në pagesën definitive dhe nëse debitori nuk posedon me mjete monetare në cilëndo xhirollogari të tij bankare,

përmbaruesi privat të bëjë regjistrimin, sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit të sipërm për llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ndër të tjera ka theksuar se e kundërshtojnë në tërësi borxhin e pretenduar nga ana e kreditorit dhe se ndaj vendimit Ae.nr 76/2020 në bazë të së cilit është kërkuar inkasimi i borxhit është paraqitur revizion duke theksuar se shkaqet e kundërshtimit janë mjaft bindëse për ta anuluar vendimin në fjalë. Më tutje ka theksuar se debitori nuk ka asnjë obligimin të pashlyer ndaj kreditorit dhe se vendimi i cili paraqitet si dokument përmbarimor me të cilën është propozuar inicimi i procedurës përmbarimore është plotësisht jo objektiv, kundërthënës dhe i ngutshëm dhe si i tillë edhe do të anulohet duke shtuar se gjykata e cila e shqyrton prapësimin duhet të jetë e kujdesshme lidhur me këtë çështje përmbarimore pa një vendim përfundimtar të Gjykatës Supreme, në mënyrë që të mos vie deri tek situata kur kreditori inkason borxhin e pretenduar në mënyrë të kundërligjshme mbi bazën e një vendimi të anuluar apo ndryshuar. Më tutje ka theksuar se vendimi i shkallës së dytë i cili i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim nuk mund të paraqitet si bazë juridike për caktimin e përmbarimit për arsye se i njëjti nuk përmban klauzolën e përmbarueshmërisë konform nenit 36 par 1 të LPP –së. I ka propozuar gjykatës që të merr aktvendim me të cilën të pranohet si i bazuar prapësimi dhe të anulohet urdhri për përmbarim P.nr.816/21 i datës 31.12.2021 i përmbaruesit privat Irfan Kërçagu.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit, në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim për faktin se revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë, duke i propozuar gjykatës që urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi, ndërsa prapësimi i debitorit të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbartimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr.816/21 të datës 31.12.2021, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) – Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.76/20 të datës 09.11.2021

Sipas dokumentit përmbartues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.76/20 të datës 09.11.2021 është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, III.C.nr 565/2018 i datës 27.11.2019 dhe është detyruar e paditura “Radio Televizioni i Kosovës”, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të borxhit nga kontrata për blerjen e veprës audio vizuale të datës 10.12.2010, t’ia paguaj shumën prej 66,246.67 €, së bashku me kamatën të cilën e paguajnë bankat afariste për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë datë 23.05.2012 e deri në pagesën definitive, ndërsa shpenzimet e procedurës kontestimore ti bartë secila palë veç e veç.

Gjykata gjen se dokumenti përmbartimor – Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë Ae.nr.76/20 i datës 09.11.2021, me të cilën është ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.565/2018 i datës 27.11.2019 është i formës së prerë nga data 09.11.2021 dhe i ekzekutueshëm nga data 02.12.2021, është dorëzuar në origjinal dhe i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”.*

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit*

*të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: “vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;”, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se “ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: “Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po qe se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se “Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përbarim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv – Aktgjykimit i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përbarimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktgjykimi është i përmbarueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përbarim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se i njëjti lidhur me këtë çështje juridike, ka parashtruar revizion në Gjykatën Supreme, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë nuk gjen mbështetje ligjore, ngase bazuar në dispozitën e nenit 213 të LPK –së, me të cilën është përcaktuar se: “Revizioni i paraqitur nuk është pengesë për përbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur”, rezulton se paraqitja e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarues mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo

procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, 24 dhe 27 të LPP-së.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbartimore, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE - Dhomat e Shkallës së Parë  
Departamenti për Çështje Ekonomike  
KPPP.nr.1572/22, datë 21.11.2022

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi  
palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve  
nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në  
Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.